



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Nr. 3840 prot.

Tiranë, më 24.7.2020

Lënda: Hartimi i Planit të Veprimit të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP) 2020 – 2022

ZNJ. ANILA DENAJ
MINISTËR I FINANCEVE DHE EKONOMISË
Tiranë

ZNJ. ETILDA GJONAJ
MINISTËR I DREJTËSISË
Tiranë

ZNJ. MIRLINDA KARÇANAJ
DREJTOR I AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT
Tiranë

Z. LORIN YMERI DREJTOR I AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE
PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)
Tiranë

Të nderuar,

Në kuadër të detyrimeve që burojnë nga anëtarësimi i Shqipërisë në Partneritetin për Qeverisjen e Hapur (PQH)¹, si një ndër instrumentet më të rëndësishëm në nivel global për të nxitur transparencën qeveritare, për të rritur pjesëmarrjen qytetare në jetën publike dhe luftuar korrupsionin, njoftoj fillimin e procesit të hartimit të planit të veprimit OGP 2020-2022.

Ky proces do të kryesohet nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri, si struktura përgjegjëse e koordinimit për Partneritetin për Qeverisjen e Hapur.

Për sa më sipër, kërkohet angazhimin i plotë dhe me prioritet i strukturave përkatëse në institucionet tuaja për hartimin e planit të veprimit për Partneritet dhe Qeverisje të Hapur (OGP)2020 – 2022. Udhëzohet që puna të zhvillohet në përputhje me paketën metodologjike, kalendarin e punës, parimeve të gjithë përfshirjes, transparencës, si dhe të përfshirjes së shoqërisë civile për hartimin e komponentëve të një plani kombëtar të konsoliduar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACË

¹ <https://www.opengovpartnership.org/members/albania/>